

# 30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



## Planet e punës për 2025, mblidhet në Bruksel, bordi i Platformës Evropiane të Rregullatorëve Audiovizive

Zbatimi i Planit të Veprimit të EPRA-s për periudhën 2024-2026, ishte në qendër të takimit të...



## Denoncimet e AMA-s për piraterinë televizive, në pranga 5 administratorë, evidentohen shkelës të tjerë




### Kryetarja e AMA-s takon kreun e OSBE-s në Shqipëri: Do të vijojmë bashkëpunimin

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Znj. Armela Krasniqi priti në ambientet e AMA-s, kreun e...

### Konventa Kombëtare për Integrimin Evropian, tryezë diskutimesh për Lirinë e Medias

Rritja e dialogut për pavarësinë dhe paanshmërinë e medias,...



### Delegacioni i Misionit të Vlerësimit të Nevojave në AMA, për rolin në monitorimin e zgjedhjeve

Roli monitorues i AMA-s gjatë procesit zgjedhor, ishte temë kryesore e takimit mes..

## Denoncimet e AMA-s për piraterinë televizive, në pranga 5 administratorë, evidentohen shkelës të tjerë

Pas denoncimit të pirate-risë televizive nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, Policia Shtetit ka arrestuar pesë administratorë subjektsh pasi shisnin paketa televizive në mënyrë pirate. Prej muajsh ekipet e AMA-s janë në terren për të identifikuar IPTV pirate në të gjitha qarqet e vendit. Ndërkaq të tjerë shkelës ligji u denoncuan në Qarkun e Beratit, Lezhës e Shkodrës. [Lexo më shumë](#)



## Planet e punës për 2025, mbledhet në Bruksel, bordi i Platformës Evropiane të Rregullatorëve Audiovizive

Zbatimi i Planit të Veprimit të EPRA-s për periudhën 2024-2026, ishte në qendër të takimit të fundit për vitin 2024, të Bordit të Platformës Evropiane të Rregullatorëve Audiovizive. Mbledhja u zhvillua në Bruksel ku ishte e pranishme kryetarja e AMA-s Znj. Armela Krasniqi, që është dhe nënkryetare e EPRA-s. [Lexo më shumë](#)



## Kryetarja e AMA-s takon kreun e OSBE-s në Shqipëri: Do të vijojmë bashkëpunimin

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Znj. Armela Krasniqi priti në ambientet e AMA-s, kreun e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadorin Z. Michel Tarran. Kreu i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, vlerësoi punën e deritanishme të bërë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive. [Lexo më shumë](#)

## Konventa Kombëtare për Integrimin Evropian, tryezë diskutimesh për Lirinë e Medias



Rritja e dialogut për pavarësinë dhe paanshmërinë e medias, bazuar në objektivat e përcaktuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës për lirinë e shprehjes, përfshirë lirinë dhe pluralizmin e medias, ka mbledhur në Tiranë, në një tryezë diskutimi, përfaqësues të Autoritetit të Mediave Audiovizive, Lëvizjes Evropiane në Shqipëri, Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë, ekspertë dhe gazetarë. [Lexo më shumë](#)



## Delegacioni i Misionit të Vlerësimit të Nevojave në AMA, për rolin në monitorimin e zgjedhjeve

Roli monitorues i AMA-s gjatë procesit zgjedhor, ishte temë kryesore e takimit mes zyrtarëve të lartë të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe delegacionit të Misionit të Vlerësimit të Nevojave (NAM), të dërguar në Shqipëri nga Zyra e OSBE-së. Vlen të theksohet se që prej vitit 2021 kur Autoriteti kryen detyrën e monitorimit të zgjedhjeve, nuk ka pasur asnjë ankesë nga subjektet politike në lidhje me këtë fakt. [Lexo më shumë](#)

